



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KOMUNA E LIPJANIT

Në mbështetje të nenit 68 par 68.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 12 të Rregullores MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport në bashkëpunim me Zyrën e Kryetarit të Komunës bënë këtë:

THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM

FTOHEN, të gjitha Organizatat e Shoqërisë Civile të Komunës së Lipjanit që janë aktive se mund të aplikojnë me projektet e tyre për ndarje të subvencioneve nga Komuna për vitin 2018.

Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve përfshijnë :

1. Çertifikata e regjistrimit,
2. Çertifikata e numrit fiskal,
3. Projekt propozimi,
4. Dëshmi që nuk ka obligime ndaj ATK-së,
5. Deklarata e përshtatshëmërisë, pranueshmërisë,
6. Konfirmimi bankar (xhirollogaria e OJQ-së),
7. Plani financiar,
8. Dorëzimi i të dhënave për personelin kyq (duke përshkruar detyrat dhe CV-e tyre)

Komuna e Lipjanit do të subvencionoj-mbështet OJQ-të në këto fusha:

1. Në fushen e Kulturës dhe Rinisë,
2. Në fushen e Inovacionit dhe teknologjisë,
3. Në fushen e aktiviteteve të personave me nevoja të veçanta.

Projektet do të subvencionohen (mbështetën) nga vlera minimale 501€ deri ne 3000 €.

Aplikantët duhet të plotësojnë deklaratën me shkrim me të cilën garantojnë që:

- I kanë kryer të gjitha obligimet nga mbështetja financiare , nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit,

- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siq parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

Mbështetja financiare do të ofrohet varësisht nga vlerësimi i projektit nga Komisioni dhe mundësitë buxhetore të Komunës.

Tërheqja dhe dorëzimi i aplikacioneve mund të bëhet në ndërtesën e Komunës kati I në Qendrën për Shërbime për Qytetarë sporteli nr. 3,

Aplikacionet e pakompletuara të paprecizuara, të panënshkrura nuk do të shqyrtohen.

Gjatë kohës kur kjo thirrje publike është e hapur , klubet sportive e interesuara mund të kërkojnë sqarime përmes postës dhe informacione shtesë përkthazi me thirrjen , por të paktën tetë (8) ditë para mbylljes së thirrjes,

Dorëzimi i aplikacioneve bëhet në zarfë të mbyllur, ku brenda zarfit vendoset një kopje e printuar e gjithë dokumentacionit original të kërkuar si dhe një kopje elektronike në CD.

Aplikuesit mund ti dorëzojnë dokumentacionin brenda afatit prej 15 ditë pune nga dita e shpalljes në Webfaqen e Komunës.

Vërejtje:

Nuk financohen aktivitetet që zgjasin më pak se 2 muaj dhe më shumë se 9 muaj, nuk financohen projektet të cilat kalojnë shumën e 20% të projektit për inventar, qiraja për zyre, si dhe nuk përkrahen projektet e OJQ-ve që tek të rinjtë mund të kenë ndikim politik, religjioz etj. Nuk do të përkrahen projekt-propozimet e OJQ-ve që në Komunë kanë avance të pambyllura, si dhe nuk do të shqyrtohen projekt-propozimet me dokumentacion të pakompletuar.

Nr. 1-660-18889
Lipjan më 28.03.2018

Kryetari i Komunes së Lipjanit
z. Imri Ahmeti

